



Drejtoria Për Arsim

07 Nr.____

Dt. 13./ 12 /2021

DATE/A:	13.12.2021
PËR/ZA/TO:	Asamblenë Komunale në Deçan
CC:	Kryetarit të Komunës z. Bashkim Ramosaj
NGA/OD/FROM:	DKA, Drejtori i Arsimit z. Bekim Vishaj
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Raporti i Punës për Periudhën Janar-Dhjetor 2021

-DKA në Deçan, planifikon aktivitete, programe dhe plane të ndryshme (në bashkëpunim me akterët tjerë të nivelit qendror qeveritar dhe jo qeveritar (OJQ)) të karakterit lokal për nxitjen drejt suksesit në mësimdhënie dhe në mësimnxënie, për të motivuar stafin arsimor që shkollat të jenë ambiente komode dhe të dashura për nxënësit dhe të tjerët, duke krijuar dhe organizuar grupe pune, dokumente (rregullore), takime, gara dhe iniciativa të ndryshme që ndikojnë direkt në rritjen e cilësisë në shkolla tona.

Aktivitetet e përditshme zyrtare të stafit të DKA-së janë:

- Koordinimi me drejtorët e shkollave për detyrat dhe aktivitetet e përditshme zyrtare.
- Përkujdesje dhe monitorim i procesit mësimor në shkollat e komunës së Deçanit.
- Organizimi i 3 Testeve (Teste obliguese nga MASHT): T. i Arritshmërisë, Testi PIRLS 2021, dhe Matura Shtetërore - 2021.
- Organizimi i Garave të diturisë, kulturore dhe sportive në nivel shkollash dhe në nivel komunal.
- Organizimi i vazhdueshëm trajnimeve të mësimdhënësve, konform kërkesave të kohës.
- Përkujdesje dhe angazhim rreth procedurave për ndërtimin e shkollave të reja, renovimin e objekteve shkollore, etj.
- Përkujdesja rreth furnizimit me pajisje dhe mjete mësimore (kabinete, pajisje teknologjike-TIK, s. sportive etj).
- Takime pune me Këshillin e Drejtorëve të Shkollave, tema diskutimi: Organizimi i Procesit mësimor në komunën e Deçanit, etj.
- Takime pune me Koordinatorët e cilësisë në nivel të shkollave, tema diskutimi: Procesi mësimor në shkollat tona, ngritja e cilësisë, zbatimi i KB dhe Garat e ndryshme me nxënësit.
- Takime me Këshillin e Prindërve (KP-niveli komunal).
- Takime pune me: MASHT, Zyrtarët e lartë të MASHT-it, SIA-Pejë, kontakte dhe bashkëpunim me Zyrtarë të MASHTI-it, Institucioneve tjera shtetërore dhe OJQ të ndryshme.
- Planifikimi dhe realizimi i obligimeve rreth Buxhetit për Arsim në nivel komune (institucionet shkollore), duke përfshirë: Administratën e Arsimit, Arsimin Fillor (18 shkolla fillore), Arsimin e Mesëm të lartë (2 shkolla), si dhe të gjitha detajet rreth ndarjes, sistemimit dhe shpenzimeve të buxhetit në bashkëpunim me drejtoritë e shkollave.

-Përgatitja dhe realizimi i Procedurave zyrtare për Konkurset (rekrutimi i punëtorëve të ri arsimor), sipas kërkesave të paraqitura nga shkollat.

-Punë me palë, zyrtarët e DKA-së (kërkesa të ndryshme të drejtuara në DKA), etj.

-Përgatitja e raporteve të punës dhe statistikave të ndryshme për MASHTI-n, etj.

Sqarim:

Aktivitetet dhe obligimet që ka paraparë dhe ka realizuar DKA, janë bazuar në PZHAK 2019-2022, ligjet dhe në rregulloret (UA) për arsim në Republikën e Kosovës.

Për të gjitha të dhënat në këtë raport pune, në DKA dhe në shkollat përkatëse ekzistojnë dëshmi, procesverbale, fotografi etj.

Vërejtje:

Edhe përkundër situatës me Pandeminë COVID 19, kemi kryer obligimet zyrtare, por kemi projekte që nuk kemi pasur mundësi për t'i realizuar.

Raporti përmban:

1. Raporti i punës për periudhën Janar-Dhjetor 2021----- (fq.1-19),

2. Raport, Investimet në shkollat e komunës së Deçanit gjatë vitit 2021---- (fq. 19-22).

Shkurtesat e përdorura:

AKK - Asociacioni i Komunave të Kosovës

AMF – Aktiv i Mësimdhënësve të Fizikës

BB - Banka Botërore

BQK – Banka Qendrore e Kosovës

DKA – Drejtoria Komunale e Arsimit

FSSH RK - Federata e Sportit Shkollor në Republikën e Kosovës

IKSHP – Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik

KB- Kurrikula Bërthamë

MASHT – Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë

MSH – Ministria e Shëndetësisë

OM – Olimpiada e Matematikës

QRSHPP – Qendra Rajonale e Shëndetit Publik në Pejë

SIA - Sektori i Inspeksionit Arsimor

SBASHK dega në Deçan

SHFMU - Shkolla Filllore e Mesme e Ulët

SHML – Shkolla e Mesme e Lartë

SHMT - Shkolla e Mesme Teknike

SHM - Shoqata e Matematicentëve

TFSH – Task Forca e Shkollës

TFK – Task Forca Komunale

USAID- U.S. Agency for International Development – USAID (Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar).

Muaji Janar:

-Përgatitja dhe dorëzimi i Planit të Punës për DKA-n (viti 2021).

- **DKA, takime pune të përjavshme TASK FORCA KOMUNALE (B. i Drejtorëve Komunal),** drejtori i DKA-së raporton për përgatitjet rreth fillimit të Gjysëmvetorit të dytë.

-**DKA (zyrtarët), gjatë këtij muaji, asiston dhe organizon këto takime të punës:**

Dt.12.01.2021, DKA (Drejtori i DKA-së) takim pune me KFOR-in, tema e takimit: Fillimi i Gjysëmvetorit të II-të në shkolla në komunën tonë.

Dt.13.01.2021, TASK FORCA KOMUNALE, Takim i punës, kryetari B. Ramosaj dhe DKA. Qëllimi i takimit: Përgatitjet e lokaleve shkollore për Gj. II-të, të punohet me Protokol të MASHT, gjithëmonë në bashkëpunim me TFSH. 19 Shkolla zhvillojnë mësimin në skenarin A, vetëm Gjimnazi në Skenarin B.

Dt.13.01.2021, Takim Punë në DKA (drejtori) me SIA-Pejë, tema e takimit: Përgatitjet (fillimi) për Gj. II-të në shkollat tona.

Dt.13.01.2021, DKA, në praninë e Kryetarit Bashkim Ramosaj, mbajti takim pune me drejtorët e shkollave të komunës sonë. Të pranishëm ishin edhe përfaqësues nga Platforma "e-Shkollori", të cilët prezantuan Platformën dhe mundësitë e implementimit të saj në shkollat tona.

Dt.13.01.2021, DKA (Drejtori i DKA-së) pret në takim pune Përfaqësuesit e Karabinierisë Italiane (Prishtinë), që janë donatorë të 2 Smart Tabelave për Gjimnazin "Vëllezërit Frashëri" dhe SHFMU "M. Çekaj", donacioni ishte i mbështetur nga MASHT.

Dt.15.01.2021, TASK FORCA KOMUNALE, Takim i rregullt i punës, pjesëmarrës: kryetari B. Ramosaj, stafi i DKA-së, dhe drejtorët e shkollave. Tema e takimit: Përgatitjet e lokaleve shkollore për Gj. II-të, të punohet me Protokol të MASHT, në bashkëpunim me TFSH.

Dt.14.01.2021, DKA (drejtori) takim online me MASHT, Përgatitjet e shkollave për Gj. II-të.

Dt.22.01.2021, DKA (drejtori) merr pjesë në takimin e K. të Drejtorëve të A. në R. e Kosovës.

Dt.28.01.2021, TASK FORCA KOMUNALE, Takim i rregullt i punës, pjesëmarrës: kryetari B. Ramosaj, stafi i DKA-së dhe drejtorët e shkollave, tema e takimit: Zhvillimi i procesit mësimor në shkolla (në kushte pandemie), Gj. II-të, po punohet me Protokol të MASHT dhe MSH.

-**Furnizimi i shkollave me mjete mësimore dhe materiale higjienike:**

-Të gjitha shkollat e komunës sonë u furnizuan me dezinfektues dhe material higjienik (pako e dytë e donacionit) nga UNICEF dhe Ambasada e Britanisë së Madhe, mbështetur nga MASHT.

-**Njësi i Karabinierisë Italiane (Prishtinë),** i dhurojnë dy Smart Tabela, për Gjimnazin "V. Frashëri" dhe SHFMU "M. Çekaj", donacioni ishte i mbështetur nga MASHT.

-**TASK FORCA KOMUNALE,** furnizimi i shkollave me material dezinfektues.

-**Të gjitha shkollat në komunën tonë, u furnizuan me inventar administrativ për zyre dhe salla të arsimitarëve, donacioni është siguruar nga Kryetari i Komunës z.Bashkim Ramosaj.**

-**Vizita pune në shkolla:**

Dt.15.01.2021, DKA, Vizita pune në shkolla, shihen nga afër përgatitjet për Gj. II-të.

-**Trajnimet e ndryshme me mësimdhënës ...:**

-Trajnim, Përgatitjet për përdorimin e platformës dixhitale shkollat.org. Zyrtari i DKA-së R. Bajramaj koordinator i mësimin online ishte pjesëmarrës në takimin online, me ç'rast u njoftu për kushtet që ofron kjo platformë në rast të kalimit të mësimin në skenarin C (mësimi nga distanca). Platforma dixhitale e të mësuarit shkollat.org implementohet nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës, ndërsa mbështetet nga Zyra e UNICEF në Kosovë në partneritet me Microsoft dhe Universitetin Cambridge.

Aktivitetet tjera zyrtare nga DKA:

Dt.28.01.2021, nga DKA, janë përgatitur 2 kërkesa (dokumente) për miratim në KPF dhe Asambleenë Komunale, Rregullorja e Punës në Institucionet Arsimore dhe Komisioni (2 anëtarë) për zgjedhjen e drejtorëve të shkollave në komunën tonë.

Muaji shkurt:

-DKA, Takime pune të përjavshme, TASK FORCA KOMUNALE (B. i Drejtorëve Komunal), drejtori i DKA-së raporton për procesin mësimor në shkolla.

-DKA (zyrtarët), gjatë këtij muaji, asiston dhe organizon këto takime të punës:

Dt.01.02.2021, DKA, Takim Pune me Aktivin e mësimdhënësve të Matematikës, Tema e takimit: Organizimi i OM në komunën tonë, me kushte pandemie.

Dt.04.02.2021, DKA, Takim Pune me Aktivin e mësimdhënësve të Fizikës, Tema e takimit: Organizimi i Garave të Fizikës “Fizikanët e Rinj” 2021 në komunën tonë.

-Dt.16.02.2021, Takim Online Drejtori i DKA-së,Prezentimi i projektit “Zhvillimi i shërbimeve të orientimit në karrierë dhe ndërmarrësisë për të rinjtë”. Pjesëmarrës: Mësimdhënësit dhe drejtorët nga SHMU-të dhe SHMP-të e komunës së Pejës, Deçanit, Klinës dhe Istogut, DKA-të e komunave përkatëse, përfaqësues nga MASHT dhe përfaqësues nga Solidar Suisse.

Vizita pune në shkolla:

-DKA (zyrtarët) vizitë shkollave “Ardhmëria” Beleg, “M. Çekaj” Irzniq, në 2 shkollat e mesme të larta në Deçan, “F. Konica” në Ratish, “E. Mekuli” në Maznikë, “J. Gërvalla” në Prapaqan, “K.V. e Llukës”, “H. e Dukagjinit”, “L. Selimi” p. Llukë e ultë, “D. e Kombit”, “I. Boletini” etj.

Dt.23.02.2021, Vizitë pune në Gjimnazin “V. Frashëri” në Deçan me Kryetarin e Komunës z. Bashkim Ramosaj, nga Drejtori i shkollës u njoftuam me zhvillimin e procesit mësimor në këtë shkollë (në kushte pandemie), njëkohësisht u bë përrurimi i investimeve në Kabinetin e Fizikës.

Dt.25.02.2021, Vizitë pune në SHMT “T. Kasumaj” në Deçan, bashkë me Kryetarin e Komunës z. Bashkim Ramosaj, nga Drejtori i shkollës u njoftuam me zhvillimin e procesit mësimor në këtë shkollë. Takim urues me Prof. Ilmi Muçaj, mësimdhënës në këtë shkollë i cili u pensionua.

-Trajnimet e ndryshme me mësimdhënës ...:

Platforma digjitale e të mësuarit, *shkollat.org #PasaportaetëMësuarit*. Platforma u lansua me një ceremoni përmes platformës ZOOM bashkë me shefin e zyrës së UNICEF-it në Kosovë, përfaqësues të komunave.

-Trajnim Online, i pranishëm në takim ishte edhe zyrtari për AML, nga DKA, Ministria e Arsimit dhe Shkencës në bashkëpunim me Zyrën e UNICEF-it në Kosovë, ka organizuar takimin validues, të propozimit për harmonizimin e Strukturës Kombëtare të Arsimit dhe Fushave të Arsimit të Mesëm të Lartë me Klasifikimin e Standardeve Ndërkombëtare të Arsimit (ISCED) 2011 dhe Fushat e Arsimit dhe Trajnimit (ISCED -F 2013).

Dt.18.02.2021, Zyrtarët nga DKA (R. Bajramaj dhe R. Prekalla), ishin pjesëmarrës në punëtorinë e organizuar nga **Caritas-i Zvicëran**, me zyrtarët e Drejtorive Komunale për Arsim, në vijim të aktiviteteve të projektit SHPRESE, ku për qëllim ishte prezantimi i databazës për grumbullimin e informatave dhe të dhënave sasiore dhe cilësore për sigurimin e cilësisë në klasat parafillore, si dhe dokumentet që priten të dalin nga databaza (raporte dhe udhëzues).

Trajnimi i mësimdhënësve parafillor (online), nga Projekti SHPRESE, janë trajnuar të gjithë edukatorët e klasave parafillore të komunës sonë, për organizimin e mësimi në kushte pandemie (m. online).

-DKA, Koordinator i KB Z. Malaj, është bërë vlerësimi i dosjeve të mësimdhënësve nga trajnimi i mbajtur në muajn Nëntor 2020, vlerësimi i dosjeve është bërë nga Mr.sc Merita Sejda.

Furnizimi i shkollave me mjete mësimore dhe materiale higjienike:

- Komuna (DKA), i furnizon shkollat me Lloptopë (42 copë) dhe video-projektorë (19 copë).
- SHFMU "Maxhun Çekaj" në Irzniq, vazhdon furnizimi me inventar nga MASHT,
- SHFMU "D. e Kombit" në St. të Ultës, banka, karrike (MASHT) etj.
- SHFMU "Ardhmëria" në Beleg, banka, karrike (MASHT) etj.

-Donacionet :

- Gj. "V. Frashëri", renovohet Kabineti i Fizikës, investim nga familja Lataj, Komuna dhe MASHT.

-z.B. Stojkaj (mërgimtar në Zvicër) nga Lloqani, 20 kompjuterë ju dhuron 2 shkollave në komunën tonë: SHFMU "S. Alaj" në Drenoc dhe "I. Boletini" në Isniq. Kompjuterët janë të formatuar dhe të gatshëm për punë, njëkohësisht z.Stojkaj, vet e ka siguruar transportin nga Zvicra (për donacionin) për në Kosovë.

-SHFMU "Drita" në Gramaçel, z.I. Hasanaj, shkollës i dhuroi ormana për vendosjen e librave për secilen klasë ku secili fëmijë e ka dollapin e vet dhe çelësin e vet. z. Hasanaj edhe më parë ka ndihmuar këtë shkollë me 300 maska për nxënës.

-Aktivitetet tjera të DKA-së:

-Dt.09.02.2021, SHFMU "I. Boletini" në Isniq, Organizon Ekspozitë me punime të nxënësve, me rastin e ditës së internetit të sigurtë.

Dt.20.02.2021, DKA me SHM në Deçan, Organizon OM në komunën tonë, në kushte pandemie, sipas rekomandimeve të IKSH, në SHMT "T. Kasumaj" në Deçan, marrin pjesë 60 nxënës.

Dt.21.02.2021, DKA në koordinim me Aktivin e mësimdhënësve të Fizikës, organizon Garat e Fizikës "Fizikanët e Rinj" në komunën tonë, nën kushte pandemie, sipas rekomandimeve të MSH, në Gjimnazin "V. Frashëri" në Deçan, marrin pjesë 30 nxënës.

-Dt.16.02.2021, DKA në bashkëpunim me Aktivin e ed. fizike, organizon Garat në nivel komunal në ping-pong në SHFMU "I. Boletini" në Isniq, morën pjesë 15 shkolla, 9 ekipe meshkuj dhe 5 ekipe vajza. fitues meshkujt, Shkolla "Maxhun Çeku" Irzniq - vendi parë, vendi dytë Shkolla "I. Boletini" Isniq, djemtë. Vajzat SHFMU "I. Boletini" Isniq-vendi parë, SHFMU "Ardhmëria" Beleg-vendi dytë.

-Dt.27.02.2021, nxënësit fitues nga komuna jonë marrin pjesë OM – Prishtinë, organizimin e bën drejtori i SHMT "T. Kasumaj" në Deçan në koordinim me DKA-në.

-Dt.28.02.2021, DKA, dergon nxënësit fitues nga komuna jonë në Garat e Fizikës "Fizikanët e Rinj" në Prishtinë, organizimin e bën DKA-në koordinim me AMF.

-Dt.13.02.2021, bëhet Dezinfektimi i objekteve shkollore (ato objekte të cilat ishin qendra votimi) nga Ekipa Komunale e Dezinfektimit.

-Dt.15.02.2021 (e hënë), Shkollat që ishin qendra të votimit, nuk mbajtën mësim (vendim i MASHT) me arsyetim se duhet përgatitur për nxënës dhe staf arsimor.

6 shkolla tjera (që nuk ishin qendra të votimit) kanë zhvilluar mësimin normalisht sipas orarit.

MUAJI MARS:

-DKA, Takime pune të përjavshme, TASK FORCA KOMUNALE (B. i Drejtorëve Komunal), drejtori i DKA-së raporton për procesin mësimor në shkollat në komunën tonë.

-DKA (zyrtarët), gjatë këtij muaji, asiston dhe organizon këto takime të punës:

Dt.17.03.2021, Takim Punë në DKA (drejtori) me SIA-Pejë. Procesit mësimor në Deçan.

Dt.02.03.2021, Drejtori i DKA-së, priti në takim pune delegacionin nga Organizata Teach For Kosova, E. Gashi shef ekzekutiv i organizatës dhe V. Morina koordinatore e projektit - Debat me të Rinjët. Projekti në bashkëpunim Teach Kosova & Solidar Suisse dhe DKA.

Dt.12.03.2021, DKA (drejtori) dhe Kryetari Ramosaj, Takim pune me disa prej drejtorëve të SHFMU të Deçanit. Tema e takimit: zhvillimi i procesit mësimor gjatë kësaj periudhe.

Dt.10.03.2021, Takim pune, Drejtori i DKA-së me Policinë e Komunitetit -St. Policor në Deçan z. Adem Çeku dhe Sh. Dautaj,diskutim rreth Zhvillimi i procesit mësimor në shkolla etj.

-Vizita pune në shkolla:

Dt.02.03.2021, Vizitë pune në SHFMU “L. e Prizrenit” në Deçan, së bashku me Kryetarin e Komunës z. Bashkim Ramosaj, nga Drejtori i shkollës u njoftuam me zhvillimin e procesit mësimor, **njëkohësisht u bë përurimi i Kabinetit të Informatikës, 10 laptop (donacion nga Komuna) dhe 5 laptop (donacion nga MASHT).**

Dt.04.03.2021, Vizitë pune në SHFMU “I. Boletini” në Isniq, së bashku me Kryetarin e Komunës z. Bashkim Ramosaj, nga Drejtori i shkollës u njoftuam me zhvillimin e procesit mësimor në këtë shkollë (në kushte pandemie), **njëkohësisht u bë përurimi i Kabinetit të Informatikës, kabineti është pajisur me 10 kompjuterë (PC) donacion nga mergimtari z.Bajram Stojkaj, 2 laptop dhe një videoprojektor (donacion nga komuna).**

-SHFMU “S. Alaj” në Dranoc, Kabineti i Informatikës, kabineti është pajisur me 10 kompjut. (PC) donacion B. Stojkaj,1 laptop dhe një v.projektor (nga komuna) dhe 3 laptop nga MASHT.

-DKA (zyrtarët) vizita pune në shumicën e SHFMU-ve dhe 2 SHML në komunën tonë.

-Aktivitetet tjera:

Dt.05.03.2021, shënohet 7 marsi - Dita e mësuesit, njëkohësisht nga DKA dhe Kryetari i komunës z. Bashkim Ramosaj, bëhet shpërndarja e mirënjohjeve për mësimdhënësit e pensionuar gjatë periudhës 8 mars 2020 - 7 mars 2021.

Dt.08.03.2021, DKA (drejtori), në Prishtinë MASHT, ceremonia e ndarjes së çmimit - "Sh. Jashari", merr mirënjohje profesori Muharrem Kukalaj, i përzgjedhur nga DKA si mësimdhënësi i vitit nga Deçani (sukseset e vazhdueshme në O. e Matematikës me nx. L. Ramosaj dhe tjerë).

Dt.20.03.2021, Organizimi i garës KANGAROO me rreth 30 nxënës në komunën tonë, gara organizohet sipas rekomandimeve të IKSHP, vendi në SHFMU “L. e Prizrenit” në Deçan.

Dt.24.03.2021, Në 23 vjetorin e fillimit të luftës së lavdishme të UÇK-së në Dukagjin dhe në 22 vjetorin e ndërhyrjes së NATO-s mbi caqet serbe, u organizua Krosoi “Ruga e Lirisë” tashmë tradicional, me nxënës të klasave të nënta nga shkollat e komunës sonë. Në këtë kros garuan dy gupe, meshkujt dhe femrat. Punohet me Protokol të MASH.

-Trajnimet e ndryshme me mësimdhënësit dhe të tjerët:

Dt.09. dhe 10. 03.2021, Drejtorët e SHFMU (18) dhe përfaqësuesi i DKA-së, morën pjesë në trajnimin 2 ditorë, tema “Shkollat e shek. 21”, organizim i B. Council dhe MASH, në Pejë.

Dt.14. 20 dhe 21.03.2021, 60 mësimdhënësit (kl.6-9) të SHFMU morën pjesë në trajnimin 3 ditorë, tema “Shkollat e shek. 21” organizim i B. Council dhe MASHT, trajnimi u organizua në SHFMU “I. Boletini” në Isniq. Në vizitë edhe ministri i MASHT z. Ramë Likaj.

Dt.11.03.2021, zyrtarët nga DKA, Z. Malaj dhe R. Bajramaj, me të gjithë drejtorët e SHFMU dhe disa mësimdhënësit, ishin pjesë e ligjërës “Ngritja e vetëdijes rreth shëndetit mendor në mjediset shkollore gjatë COVID-19”. Ligjërata është mundësuar me përkrahjen e Organizatës Botërore të Shëndetësisë, në bashkëpunim me MASHT dhe IKSHP.

Dt.28.03.2021, Trajnim me mësimdhënësit nga Komuna e Deçanit (10 mësimdhënësit), Junikut dhe Gjakovës, ishin pjesë e trajnimit, i organizuar IOM bashkë me MASHT dhe DKA-të: Deçan, Gjakovë dhe Junik, me temën: “Me shkollat për komunitete të sigurta”-Faza II. Trajner Drejtori Phd Hysen Balaj.

MUAJI PRILL:

-DKA, Takime pune të përjavshme, TASK FORCA KOMUNALE (B. i Drejtorëve Komunal), drejtori i DKA-së raporton për gjendjen në arsim.

-DKA, kërkesë për Shkollën e Ultë të Muzikës në Deçan, kërkesë kjo drejtuar në MASHT.

-DKA, kërkesë për Një Paralele të Infermierisë në SHMT “T. Kasumaj”, drejtuar në MASHT.

-DKA (zyrtarët), gjatë këtij muaji asiston dhe organizon këto takime të punës:

Dt.05.04.2021, Takimi i Radhës KKSBB në Deçan, Drejtori i DKA-së, raporton për gjendjen në arsim në shkollat në komunën tonë, gjendja me pandemi.

Dt.07.04.2021, Takim online me MASHT, pjesëmarrës Drejtori i DKA-së.

Takime pune me përfaqësues të: KFOR, OSBE, Policinë e Kosovës – Deçan, OJQ, tema diskutimi: zhvillimi i procesit mësimor në komunën e Deçanit.

-Vizita pune në shkolla:

Gjatë këtij muaj nga zyrtarët e DKA-së, me vizita pune janë vizituar shumica e shkollave: SHMT “T. Kasumaj”, “V. Frashëri”, “D. e Vokshit”, “Drita”, “M. Çekaj”, “L. Selimi”, “J. Gërvalla” etj.

-Aktivitetet tjera:

Dt.02.04.2021, “Dita botërore e autizmit”, shenohet me aktivitete të ndryshme në mënyrë simbolike në disa prej shkollave tona në komunë.

Dt.20.04.2021, Garat komunale në hendboll meshkujt, organizon FSSH, Vendi i parë SHFMU “B. Curri” nga Strelci i Epërm

Dt.21.04.2021, Garat komunale në hendboll vajzat, organizon FSSH, Vendi i parë SHFMU “M. Çekaj” nga Irzniqi.

Dt.23.04.2021, Garat nderkomunale në hendboll meshkujt, organizon FSSH,

Dt.30.04.2021, Garat republikane në hendboll meshkujt, nga Deçani merr pjesë SHFMU “B. Curri” nga Strelci i Epërm (në Drenas), vendi i Dytë nivel Kosove.

Për mbarëvajtjen dhe ndihmë për këto gara është përkujdesur zyrtari i DKA-së Z. Malaj. DKA, falenderon prof. Shyqyri Zeqiraj (kryetar i FSSH në Deçan) dhe mësimdhënësit tjerë të ed. fizike. Garat janë organizuar sipas Protokolit të MSH dhe MASHT.

-Trajnimet e mësimdhënësve dhe të tjerëve:

SBASHK në Deçan, trajnim i mësimdhënësve, tema “Zhvillimi në karrierë” DKA i ndihmon.

Dt.12.04.2021, DKA, trajnon mësimdhënësit e 4 shkollave, pjesëmarrëse me nxënës në testin ndërkombëtar PIRLS, SHFMU “L. e Prizrenit”, “D. e Baballoqit”, “I. Boletini”, “K. Verrave të Llukës” Llukë e Epërm .

Vërejtje:

Prej dt.29.03.-02.4.2021, Përfundimi i Periudhës së Dytë Mësimore - Pushimi pranveror.

Dt.12-15.04.2021, me Vendim të MASHT, Organizohet nje javë mësimi online.

MUAJI MAJ:

-DKA, Takime pune të përjavshme, TASK FORCA KOMUNALE (B. i Drejtorëve Komunal), drejtori i DKA-së raporton për gjendjen në arsim.

-Përgatitja e raportit për Performancë të Komunës (nga DKA i angazhuar zyrtari R. Bajramaj).

-Gjatë këtij muaji, zhvillohen procedurat e Konkursit për zgjedhjen e 7 drejtorëve të SHFMU-ve.

-Shërbimi administratës i plotëson dhe i dorëzon kërkesat e ndryshme nga MASHT, SIA-Pejë.

-Kërkesa në MASHT, Regjistrimi i nxënësve, Parafillor, fillor (kl. I-rë) dhe kl. e X-ta.

-DKA (zyrtarët), gjatë këtij muaji asiston dhe organizon këto takime të punës:

Dt. 07.05.2021, Drejtori i DKA-së, Takim pune në MASHT (drejtorët komunal), me ministren e arsimit, tema: zhvillimi i procesit mësimor gjatë kësaj periudhe.

Dt.11.05.2021, Takim Online, merr pjesë Drejtori i DKA-së, organizon Instituti GAP. Tema: Analizë e sistemit arsimor në Kosovë, shkollat (numri i nxënësve etj).

Dt.18.05.2021, Takim Online, merr pjesë Drejtori i DKA-së, organizon USAID.

Dt.25.05.2021, Takim punë, Drejtori i DKA-së, në AKK – Kolegjiumi për Arsim.

Dt.12.05.2021, në DKA, Takim përshëndetës me drejtorin e SHMT “Tafil Kasumaj” në Deçan z. Zenel Kasumaj i cili nga sot pensionohet, falenderim dhe respekt për punën e bërë në udhëheqjen e shkollës për mbi 20 vite, me këtë rast z. Kasumaj ju nda mirënjohje.

-Vizita pune në teren (shkolla):

Dt.25.05.2021, Vizitë pune në SHMT “Tafil Kasumaj” në Deçan, takim urues me drejtorin e ri z.Lan Stojkaj, u njoftuam me zhvillimin e procesit mësimor në shkollë (në kushte pandemie).

-DKA, sjellë VENDIM, bazuar në vendimin e MASHT te dt.31.03.2021, nr.01/B/02. Për ndryshimin e kalendarit të vitit shkollor 2020/2021 në arsimin parauniversitar (Citojmë: në fund të periudhës së tretë, do të vazhdoj procesi mësimor në shkolla (në të gjitha nivelet) për pesë (5) ditë mësimi, dy (2) ditët tjera u takon komunave të përcaktojnë ditët e shtuna për mbajtjen e mësimi, në shkollat e Deçanit zëvendësohet dy (2) ditë e humbura të mësimi të shtunëve me dt. 22. dhe 29.05.2021. Mësimi është zhvilluar normalisht sipas dinamikës së paraparë nga DKA. Me vendimin janë njoftuar shkollat, SIA (Pejë).

-Aktivitetet tjera:

Dt. 04.05.2021, Për nder të “Ditës së dëshmorëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës në komunë e Deçanit”, u organizua ekspozitë me punime të nxënësve të shkollave FMU të komunës sonë. Ekspozita u hap në ora 10:00, në pallatin e kulturës “Jusuf Gërvalla”. Ekspozita kspozita është organizuar nën patronatin e Kryetarit të Komunës së Deçanit z. Bashkim Ramosaj.

-SHFMU “Rexhep Kadrijaj” dhe “H. e Dukagjinit” po realizojnë Projektin e Huamarrjes nga BB, ndihmuar dhe asistuar nga DKA - zyrtarja Gj. Haklaj.

Dt.18.05.2021, Përfundimi i mësimi për maturan të (kl. 12-të).

-DKA, Përgatitjet për mbajtjen e testeve: T. arritshmerisë, T. Maturës Shtetërore dhe T. PIRLS.

Dt. 28.05.2021, sot në Deçan mbahet Testi i Arritshmërisë me nxënës të klasave të IX-ta, testi është organizuar në 3 qendra morën pjesë 406 nxënës.

-Kryetari i Komunës z. Bashkim Ramosaj dhe DKA, presin nxënësit SHFMU “B. Curri” nga Strellci i Epërm fitues në Garat republikane në hendboll meshkujt, vendi i Dytë nivel Kosove.

-Investimet në shkolla:

-SHFMU “K.V. të Llukës”, donacion nga NP “Hixhena” në Deçan, karrika, shporta të mbeturinave të oborrit,si dhe pemë dekoruese për oborrin e shkollës.

-SHFMU “Ardhmëria”, donacion nga NP “Hixhena” në Deçan, karrika, shporta të mbeturinave të oborrit,si dhe pemë dekoruese për oborrin e shkollës.

-SHFMU “B. Curri”, ulëse,shporta në oborr,donacion nga NP “Hixhena” në Deçan dhe MASHT.

-Furnizimi i shkollave me mjete mësimore dhe materiale higjenike:

-Të gjitha shkollat e komunës sonë u furnizuan me dezinfektues dhe meterial nga Komuna. SHFMU “Rexhep Kadrijaj”, Projekti i Huamarrjes nga BB, 16 loptop, pajisje mësimore 7 kabineteve,1 fotokopje,1 Tabelë Interaktive, 80 tituj (nga 5 kopje) te ri për Bibliotekën e shkollës, mjete zerimi, vegla muzikore etj.

SHFMU “H. e Dukagjinit”, nga Projekti i Huamarrjes nga BB, 9 loptop, pajisje mësimore 7 kabineteve,1 projektor,1 Tabelë Elektronike, 300 tituj te ri për Bibliotekën e shkollës, mjete zerimi, vegla muzikore etj.

MUAJI QERSHOR:

-DKA, Takime pune të përjavshme, TASK FORCA KOMUNALE (B. i Drejtorëve Komunal), drejtori i DKA-së raporton për gjendjen në arsim.

-DKA (zyrtarët), gjatë këtij muaji asiston dhe organizon këto takime të punës:

-Drejtori i DKA-së, priti në takim konsulentet e pavarura znj Aurelie Viard dhe V. Jasharaj,nga Organizata SOLIDAR SUISSE. Temë takimi ishte: gjithëpërfshirja në arsim, me theks të veçantë, femrat dhe grupet minoritare, mundësitë e punësimit pas përfundimit të shkollës së mesme, shkolla e mesme teknike dhe profilet që kërkohen në tregun e punës.

Dt.30.06.2021, Drejtori i DKA-së dhe drejtori i SHMT “T. Kasumaj” ishin në Takim Pune me z.D. Berisha, zyrtar i org. ITED L.L.C..Tema e takimit: fillimi i bashkëpunimit me këtë organizatë dhe më org. SOLIDAR SUISSE.

Dt.01.06.2021, DKA, vizitë në SHFMU “M. Çekaj”, me rastin e 1 qershorit-dita e fëmijëve (kl. 3-të përurimi i kabinetit të gj. angleze).

Dt.01.06.2021, DKA (drejtori) dhe drejtori i SHFMU “L. e Prizrenit” në Deçan Q. Maloku, me 15 nxënës (kl. I-rë) të kësaj shkolle, në vizitë në stacionin e Policisë në Deçan, me rastin e 1 Qershorit-Dita e fëmijëve, nxënësit u pritën nga dhe komandanti z. F. Jahmurataj dhe stafi.

Dt.05.06.2021, “Dita botërore e mjedisit”, shenohet me aktivitete të ndryshme në shkolla.

-Zyrtarët e DKA-së, realizojnë vizita pune në shumë prej shkollave në komunën tonë.

-Organizimi i Testeve obliguese për nxënës:

Dt.18.06.2021, Testi Ndërkombëtar “PIRLS-2021” 90 nxënës nga SHFMU në komunën e Deçanit, marrin pjesë në këtë test nxënës te kl. të 4-ta. Shkollat nga komuna e Deçanit janë: SHFMU “Lidhja e Prizrenit” Deçan,

SHFMU “Isa Boletini” Isniq,

SHFMU “K. Verrave të Llukës” Llukë e Epërm,

SHFMU “Dëshmorët e Baballoqit” Baballoq.

Shkollat dhe nxënësit janë përzgjedhur nga MASHT, Testi u zhvillua në SHFMU “L. e Prizrenit” dhe në SHFMU “I. Boletini” në Isniq.

Dt.26.06.2021, MATURA SHETETËRORE 2021 afati i Qershorit, morën pjesë rreth 320 maturantë.Testi u organizua në 3 qendra: Gjimnazin “V. Frashëri”, SHMT “T.Kasumaj”, SHFMU” L. e Prizrenit”.

-Trajnimet e ndryshme për mësimdhënës dhe të tjerët:

Dt.10.06.2021, DKA (zyrtari Z. Malaj), trajnon 44 administruesit e përzgjedhur nga komuna jonë, të cilët u trajnuan për të Administruar Testin e Maturës Shtetërore. Temat: roli, detyrat dhe përgjegjësitë e administruesit dhe mbikëqyrësit në ditën e testimit. I pranishëm në këtë trajnim ishte edhe anëtar i komisionit të MSH z. Besim Avdimetaj (drejtor i DKA-së në Pejë).

-Trajnim për 15 mësimdhënësit e SHFMU “R. Kadrijaj”, tema “Mësimdhënia me TIK” Projekt-Pako i përfituar nga P. Huamarrjes (BB), tranimi ishte 5 ditorë.

-Trajnim për 10 mësimdhënësit e SHFMU “H. e Dukagjinit”, tema “Mësimdhënia me TIK” Projekt i përbashkët me SHMT “T. Kasumaj”, trajnim 5 ditorë, trajnerët mësimdhënës në SHMT.

-SHMT “T. Kasumaj”, Gjimnazi “V. Frashëri” në Deçan dhe SHFMU “B. Curri” nga Strelci i Epërm, me nxënësit e tyre (rreth 30 nxënës) kanë marrë pjesë në projektin Kreativ “Qendrat Kreative për Shkollat e Mesme të Kosovës”, projekti ka filluar në Tetor të vitit 2019 dhe ka përfunduar në Qershor 2021 (me ndërprerje kohë pas kohe, shkaku i pandemisë). Projekti është organizuar nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik dhe PBC Academy, qëllimi i projektit ishte për të krijuar një partneritet efektiv në mbështetje të rinisë së vendit. Nxënësit tonë kanë pasur mundësinë që të njoftohen për se afërmi me teknologjitë dhe trendet e fundit botërore

duke përfshirë Programim të orientuar në objekte: AURDUINO, LITTLE BITS, RASPBERRY PI, Dizajnim dhe Printim 3D dhe njohuri të tjera në fushën e TIK-ut, kjo u arrit gjatë trajnimeve të nxënësve nga PBC Academy. Nxënësit e trajnuar kanë arritur të krijojnë disa projekte praktike.

-Gjatë muajt qershor, DKA organizon Garat e Diturisë me nxënësit:

Për mbarëvajtjen e garave është përkujdesur zyrtari i DKA-së R. Bajramaj me kolegë.

Po ashtu DKA, falenderon mësime të lëndëve në gara, drejtorët e shkollave, 2 drejtoritë e SHML në Deçan, me theks të veçantë prof. Muharrem Kukalaj, prof. Ramë Dobraj. Prof. Musa Stojkaj, prof. Egzontina Zyberi, prof. Bajram Tahiraj etj.

Dt.12.06.2021, DKA me SHM në Deçan, Organizon gara në lëndën e matematikës me nxënësit e kl. 6,7 dhe 8 në nivel komunal, garat organizohen sipas rekomandimeve të IKSH, garat zhvillohen në SHMT “T. Kasumaj” në Deçan. Garën e udhëhoqi prof. Muharrem Kukalaj. Morën pjesë: 21 nxënës nga klasat e 6-ta, 16 nxënës nga klasat e 7-ta dhe 15 nxënës nga klasat e 8-ta.

Dt.19.06.2021, DKA në koordinim me Aktivin e mësime të lëndëve në Fizikë organizon, Garat në lëndën e Fizikës me nxënësit e kl. 6,7 dhe 8, nivel komunal, nxënësit e shkollave në komunën tonë. Garat zhvillohen në Gjimnazin “V. Frashëri” në Deçan, marrin pjesë rreth 59 nxënës.

Garën e udhëhoqi prof. Ramë Dobraj. Në garë kanë marrë pjesë: 20 nxënës nga klasat e 6-ta, 19 nxënës nga klasat e 7-ta dhe 20 nxënës nga klasat e 8-ta.

Dt.25.06.2021, u zhvilluan Gara të Diturisë nga Gjuha dhe Letërsia Shqipe, për klasat e 6-ta, 7-ta dhe 8-ta nxënës në shkollat fillore të komunës sonë. Garat ishin në përkujdesjen e Profesorit Musa Stojkaj, Bajram Tahiraj dhe arsimtarëve vullnetarë nga shkollat e Deçanit. Garat u zhvilluan në Gjimnazin “V. Frashëri”. Në garë morën pjesë: 31 nxënës nga klasat e 6-ta, 31 nxënës nga klasat e 7-ta dhe 34 nxënës nga klasat e 8-ta.

Dt. 29.06.2021, u zhvillua Gara e Diturisë nga Gjuha Angleze, për klasat e 6-ta, 7-ta dhe 8-ta nxënës në shkollat fillore të komunës sonë. Garat ishin në përkujdesjen e Prof. Egzontina Zyberi, arsimtarëve vullnetarë nga shkollat e Deçanit dhe zyrtarëve nga DKA. Garat u zhvilluan në SHMT “T. Kasumaj”. Në garë kanë marrë pjesë: 28 nxënës nga klasat e 6-ta, 28 nxënës nga klasat e 7-ta dhe 29 nxënës nga klasat e 8-ta.

-Aktivitete tjera:

DKA, zyrtarët R. Bajramaj dhe B. Cacaj. Përgatitja e Projektit dhe Konkursit për Bursa Studentëve Deçanas. Ky draft propozim i është dorëzuar Komisionit në nivel Komunal për ndarjen e bursave.

Dt.18.06.2021, Shpallet lista e ngushtë (version preliminar) e shkollave aplikuese për përfitim nga projekti “kidpreneurship - Think, Design, Create”. Në mesin e 68 shkollave aplikuese ishte edhe SHFMU “Drita” në Gramaçel, e cila është kualifikuar për fazën e dytë të vlerësimit në mesin e 16 shkollave me të mira, gara vazhdon ...

-DKA me drejtoritë e shkollave përgatitë listën për furnizim me tekste shkollore për nxënësit.

-DKA dhe drejtoritë e SHFMU-ve, Vlerësimi i teksteve shkollore (alternative) për disa lëndë në SHFMU (aktivet profesionale), proces i sukseshëm.

-BQK, dhuron për nxënësit, MASHT në bashkëpunim me Departamentin për Zhvillim të Fondit Evropian për Evropën Juglindore (EFSE DF), ka arritur që të sigurojmë, për secilën klasë nga një set librave, për klasat 1-5. Me qëllim të përfshirjes së të gjithë nxënësve të Kosovës Projektin “Edukimi Financiar”. Librat përdoren material shtesë në lëndën mësimore “Shkathtësi për Jetë”.

-DKA me drejtoritë e shkollave, përgatitë listën për regjistrimin e nxënësve parafillor dhe kl. I-rë.

-DKA me drejtoritë e shkollave, përgatitë listën për regjistrimin e nxënësve në kl. e 10-ta.

-Dt.21.06.2021, Përfundimi i mësimit për kl. 9, 10, 11.

-Dt.15.06.2021, Drejtoria Komunale e Arsimit, në bashkëpunim me zyrën e kryetarit të komunës z.Bashkim Ramosaj në kuadër të shënimit të 22 vjetorit Ditës së Çlirimit të qytetit të Deçanit, kanë ndarë mirënjohje të veçanta për mësime të pensionuar të cilët kanë ndërruar jetë gjatë kohës së Pandemisë COVID-19, në periudhën kohore mars 2020-maj 2021 dhe për të cilët nuk kemi mbajtur mbledhje komemorative.

Dt.28-31.06.2021, -DKA shpall konkurs-afati i parë (afati i paraparë nga MASHTI) për regjistrimin e nxënësve në kl. e 10-ta, me drejtoritë e 2 SHML.

Dt.04.06.2021, Gara për Ese për nxënës të SHML, organizuar nga OSBE-së në bashkëpunim me drejtoritë komunale të arsimit rajonit të Dukagjinit, tema: “A e keni mendimin tuaj për rolin që qeverisja lokale mund të luaj për të ardhmën tuaj dhe për shërbimet e qëndrueshme në komunën tuaj ? Fituese e garës Mimoza Beqiraj nga SHMT “T. Kasumaj”. Nxënëses M. Beqiraj ju dhurua letër motivuese nga zyrtarët e OSBE-së në Pejë dhe një roman, në shenjë falenderimi për pjesëmarrje në garën Regjionale për ESE.

-Investimet dhe donacionet në shkollë:

-SHFMU “B. Curri” në Strellc të epërm, donacion (32 kompjuterë 2 printera) nga Bekë Mulaj. Po ashtu Rifat R. Berisha dhe Shkelzen G. Berisha donacion për nxënës, 6 veshje kombëtare.

Vërejtje:

Aktivitetet e përditshme të zyrtarëve të DKA-së kanë vazhduar...

-DKA, Procedurat për konkurset - rekrutimi i stafit (punëtorëve) të ri arsimor, sipas kërkesave të shkollave, janë përkujdesur zyrtarët Xh. Bozhdaraj dhe B. Cacaj.

-Vazhdimisht kryhen obligimet administrative, pëlqime, vendime, kërkesa e shkresa tjera zyrtare nga zyrtari B. Prekalla.

-Realizimi, përcjellja e obligimeve financiare për shkollë nga zyrtarja Gj. Haklaj.

-DKA, ndryshimet e nevojshme në listat e pagave për punëtorët arsimor për këtë muaj, janë përkujdesur zyrtarët Z. Malaj dhe B. Prekalla.

-Viti Mësimor 2020/2021, ka përfunduar me dt.02.07.2021.

Raport i detajuar mbi situatën me Pandeminë COVID 19, periudha janar – qershor 2021:

-Përcjellja e situatës (mësimi në kushte pandemie) në shkollë është bërë në vazhdimësi.

-DKA, raport i përditshëm për SIA-Pejë, rreth zhvillimit të procesit mësimor në komunën tonë, raport me shkrim për tërë javën (muajin) për SIA-Pejë dhe për Task Forcën Komunale.

-Shkollat, vazhdimisht janë pajisur me material dezinfektimi dhe higjenik dhe janë dezinfektuar sipas afateve të parapara.

Me dezinifektues, maska, e material tjetër higjenik shkollat janë ndihmuar nga OJQ vendore dhe ndërkombëtare, donatorë privat (individual), nga MASHT, Komuna etj.

Janë mbajtur kontakte, DKA me SIA, MASHT, Task forcën Komunale, drejtoritë dhe Task Forcat e shkollave.

-Gjatë kësaj kohe, shkollat janë vizituar nga akterë të ndryshëm: DKA, SIA, MASHT, Inspektor sanitar, etj.

Rastet, mësime të COVID 19, sipas shkollave:

Dt.25.01.2021, SHFMU “D. e Baballoqit” Baballoq, 1 mësime të COVID 19.

Dt.01.02.2021, SHFMU “F. Konica” Ratishë, 1 mësime të COVID 19.

Dt.23.02.2021, SHFMU “D. e Vokshit” Pobergjë, 1 mësime të COVID 19.

Dt.17.03.2021, SHFMU “L. e Prizrenit” Deçan, 1 mësime të COVID 19.

Dt.22.03.2021, SHFMU “L. e Prizrenit” në Deçan, 1 rast (mësime të COVID 19).

Dt.24.03.2021, Gjimnazi “V. Frashëri” në Deçan, 1 rast (mësimdhënës) pozitiv me COVID 19.

Dt.13.04.2021, SHMT “T. Kasumaj” në Deçan, 1 rast (mësimdhënës) pozitiv me COVID 19.

Dt.13.04.2021, SHFMU “S. Alaj”, 1 rast (mësimdhënës) pozitiv me COVID 19.

Gjithësejt 7 mësimdhënës me Covid 19.

Rastet, nxënës me COVID 19, sipas shkollave:

Dt.19.02.2021, SHFMU “K.V. e Llukës”, 1 nxënës pozitiv me COVID 19.

Dt.25.02.2021, Gj. “V. Frashëri” në Deçan, 1 nxënës pozitiv me COVID 19.

Dt.25.03.2021, SHFMU “M. Çekaj” në Irzniq, 1 nxënës pozitiv me COVID 19.

Dt.02.04.2021, Gjimnazi “V. Frashëri” në Deçan, 7 nxënës pozitiv me COVID 19.

Dt.28.04.2021, SHFMU “L. e Prizrenit” në Deçan, 1 nxënës pozitiv me COVID 19.

Dt.07.05.2021, SHFMU “Drita” në Gramaqel, 1 nxënës pozitiv me COVID 19.

Gjithësejt 12 nxënës me Covid 19.

Në rastet e lartëcekura dhe tjera, nga shkollat është punuar me Protokol të MASHT, IKSHPK, MSH dhe me vendimet e TASK FORCËS së shkollës (shkollave) dhe Komunës.

Muaji KORRIK:

Dt.02.07.2021, DKA ndanë Mirënjohjet për nxënësit fitues në Garat e Ditursë - Qershor 2021.

Dt.02.07.2021, Përfundimi i procesit mësimor.

DKA, takime pune:

Dt.02.07.2021, Takimi i radhës KKSBB në Deçan, Drejtori i DKA-së, raporton për zhvillimin e procesit mësimor në shkollat e komunës sonë, gjendja me pandemi.

Dt. 06-07.07.2021, Seminar KD, pjesëmarrës drejtori i DKA-së me zyrtarin B. Cacaj.

Dt.08.07.2021, Takim me Drejtorët e SHFMU dhe SHML në komunën e Deçanit. Tema te Takimit: 1. Përfundimi i vitit shkollor (mësimor) 2020/21. 2. Përgatitjet për fillimin e vitit të ri shkollor 2021/22, 3. Të ndryshme.

Dt.09.07.2021, Kryetari i komunës z. Bashkim Ramosaj, takim me drejtorët e shkollave dhe punëtorët teknik. Falenderim për punën e bërë gjatë këtij viti shkollor në shkolla (mbajtja e hixhenës dhe rregullit gjatë këtij viti shkollor me pandeminë).

-Dt.03.08.2021, DKA përgatitë për Asamblenë Komunale “**Raportin e Punës për Periudhën Janar-Qershor 2021**”.

-Dt.09.07.2021,DKA, Shpallja e Konkursit të rregullt, rekrutimi i stafit (punëtorëve) të ri arsimor për fillimin e vitit të ri shkollor 2021/2022.

DKA, kërkesat drejtuar në MASHT:

Dt.13.07.2021, DKA, përgatitë dhe ridorëzon listën (numrin më numër) e nxënësve për furnizim me tekste shkollore.

Dt.15.07.2021, Kërkesa nga MASHT, lidhja me kanalizim i objektit të ri shkollor “Drita” në Gramaqel.

Dt.15.07.2021, Kërkesa nga MASHT, për leje të ndërtimi për sallën e Ed. Fizike në SHMT “T. Kasumaj” në Deçan.

DKA, Përgatitja për lidhje të fortë (botim) të Rregullores për Institucionet Edukative-Arsimore të Komunës së Deçanit.

Dt.09.07.2021, DKA, Kërkesë për Shkollën e Ultë të Muzikës në Deçan, kërkesë kjo drejtuar në MASHT, kërkesë e përsëritur.

DKA, Kërkesë për 1 Paralele të Infermierisë në Deçan (SHMT “T. Kasumaj”), drejtuar në MASHT, Kërkesë e përsëritur për afatin e 2-të për regjistrimin e nxënësve në kl. të 10-të.

Muaji GUSHT:

Dt.03.08.2021, DKA, me 2 pika ishte në rend dite në Asamblenë Komunale:

1. **“Raporti i Punës për Periudhën Janar-Qershor 2021”.**

2. Kërkesa nga MASHT, për leje të ndërtimi për sallën e Ed. Fizike në SHMT “T. Kasumaj”.

Dt.09.08.2021, DKA, bashkë me Kryetarin e Komunës z. Bashkim Ramosaj, drejtorin e SHMT “Tafil Kasumaj” në Deçan, Takim urues me Prof. Milaim Qorraj, mësimdhënës në këtë shkollë i cili u pensionua, me këtë rast i pari i komunës z. Ramosaj, profesorit Qorraj i ndau mirënjohje, me motivacion “për kontributin e dhënë në fushën e arsimit”.

Dt.13.08.2021, MASHT, përgjigje (vendim) për 1 Paralele të Infermierisë në Deçan (SHMT “T. Kasumaj”), drejtuar në MASHT, kërkesë e përsëritur për afatin e 2-të për regjistrimin e nxënësve në kl. të 10-të. Kërkesa është miratuar nga MASHT.

-DKA, në bashkëpunim me drejtorinë e Urbanizmit, Zyrën e Prokurimit, me drejtoritë e shkollave, dhe në koordinim me zyren e Kryetarit ka përgatitur disa projekte për renovim dhe rregullim të ambienteve shkollore në komunën tonë. Kjo është bërë në bazë të kërkesave të shkollave, arsyeshmerisë (nga Komisioni i punës) dhe mundësive bugetore që ka komuna.

-TASK FORCA KOMUNALE, Takim i punës, kryetari B. Ramosaj dhe DKA.

Qëllimi i takimit: Përgatitjet e lokaleve shkollore për fillim të vitit të ri shkollor 2021/2022.

-DKA, Të gjitha shkollat e komunës sonë u furnizuan me material administrativ, dezinfektues dhe material tjetër higjienik, etj.

-DKA, zyrtarët R. Bajramaj dhe B. Cacaj. Përgatitja e Projektit dhe Konkursit për Bursa Studentëve Deçanas. Ky draft propozim i është dorëzuar Komisionit në nivel Komunal për ndarjen e bursave.

-DKA, Shpallja e Konkursit plotësues, rekrutimi i stafit (punëtorëve) të ri arsimor për fillimin e vitit të ri shkollor 2021/2022.

Dt.19.08.2021, është shpallur Konkursi për ndarjen e bursave. Konkursi është hapur për vitin akademik 2019/2020.

Dt.23.08.2021, Konkursi plotësues (afati i gushtit), për regjistrimin e nxënësve në klasën e dhjetë në Gjimnazin “Vëllezërit Frashëri” dhe ShMT “T. Kasumaj”.

Dt.24.08.2021, TASK FORCA KOMUNALE, Takim i rregullt i punës, pjesëmarrës: kryetari B. Ramosaj, stafi i DKA-së dhe drejtorët e shkollave, tema e takimit: Fillimi i vitit të ri shkollor 2021/2022, (në kushte pandemie), **të punohet me Protokol të MASHT dhe MSH.**

Dt.16.08.2021, Sot, të gjithë punëtorët e arsimit në shkollat tona janë lajmëruar në punë (pas pushimeve verore), për të bërë përgatitjet e duhura për fillimin e vitit të ri shkollor 2021/2022. Drejtoritë e shkollave kanë raportuar se janë duke u bërë më kohë përgatitjet e duhura.

Dt.16.08.2021, DKA-Qendra e trajnimeve dhe për zhvillim në karrierë (në P. e Kulturës në Deçan) është pajisur me inventar të duhur për punë dhe aktivitete profesionale.

Dt.28.08.2021, MSH, sot mbahet "Provimi i Maturës Shtetërore 2021", afati i dytë.

Provimi u zhvillua në një qendër (Gj. “V. Frashëri”). Provimit ju nënshtruan 73 maturantë.

Dt.31.08.2021, nga MASHT, DKA sot fillon furnizimin me tekste shkollore falas për të gjithë nxënësit e Shkollave Filllore të Mesme të Ulëta të komunës së Deçanit.

-Donacionet dhënë shkollave:

SHFMU "Dëshmorët e Vokshit" Pobërgjë. Donacioni me 8 videoprojektorë nga Shoqata humanitare “Mentori&Agimi” Zvicer.

SHFMU "Jusuf Gërvalla" Prapaqan-Deçan, Komuniteti ndihmon kolektivin e shkollës për rregullimin e ambientit në objektin e shkollës në Dubovikë.

Muaji SHTATOR:

Vërejtje:

Mësimi nuk ka filluar siç është paraparë me 1 Shtator 2021, me një Vendim të Qeverisë, e kjo për shkak të gjendjes me pandeminë (mësimi është shtyrë deri me dt. 13.09.2021).

Po ashtu edhe me një Vendim tjetër të Qeverisë së Kosovës, mësimi është shtyrë deri me dt.26.09.2021. Arsyeja e njëjtë (Pandemia në vend).

Dt.10.09.2021, Takim pune me drejtorët e shkollave. Gjatë takimit u diskutua për mundësitë e fillimit të vitit të ri shkollor në kushtet e pandemisë Covid-19, sipas udhëzuesit të MASHT-it. Vaksinimi i stafit të shkollave që është në vazhdim e sipër dhe tema tjera me interes për fillim të mbarë të procesit edukativo-arsimor.

Dt.07.09.2021, DKA (drejtori) Takim Online me MASHT, përgatitjet për fillimin e vitit të ri shkollor 2021/2022.

Dt.20.09.2021, Takim pune me drejtorët e shkollave, diskutim publik për bugjetin 2022 (AK), Pjesa e dytë e takimit ishte: përgatitjet dhe mundësitë e fillimit të vitit të ri shkollor në kushtet e pandemisë Covid-19, sipas udhëzuesit të MASHT-it. Vaksinimi i stafit të shkollave që është në vazhdim e sipër dhe tema tjera me interes për fillim të mbarë të procesit edukativo-arsimor.

Dt.10.09.2021, Fillon trajnimi gjashtëditor për Kurrikulë, me 24 mësimdhënësit e komunës sonë. Trajnimi organizohet nga DKA, përkatësisht koordinatori për kurrikulë në DKA, në bashkëpunim me MASHT-in.

-Dt.17.09.2021, Zyrtari nga DKA R. Bajramaj, ishte pjesëmarrës në punëtorinë dy-ditore të organizuar nga HANDIKOS në partneritet me SOS Fshatrat e Fëmijëve në Kosovë, financuar nga Bashkimi Evropian dhe menaxhuar nga Zyra e Komisionit Evropian në Kosovë, për inicimin e qasjes multidisiplinare dhe shkëmbimin e përvojave të ndryshme, në mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, në veçanti fëmijëve me nevojë të veçanta.

-DKA, në bashkëpunim me drejtorinë e Urbanizmit, Zyrën e Prokurimit, me drejtoritë e shkollave dhe në koordinim me zyren e Kryetarit ka përgatitë Projektin për renovim dhe rregullim të ambienteve në disa shkolla të komunës sonë.

Dt. 27.09.2021, Fillimi i procesit mësimor në shkollat e komunës, të gjitha shkollat fillojnë mësimin në Skenarin 1 (rikthim në objektet shkollore) sipas MASHTI-it, 2 shkollat e qytetit (SHFMU "L.P" dhe Gj. "V.F") kanë nga 3 paralele në mësim online (shkak numri i madh i nxënësve në klasa). Në shkolla po punohet me Protokol të MASHT-it dhe vendimit të TASK FORCËS së shkollës (përkrahur nga TFK).

-Vizita pune në shkolla: nga stafi i DKA-së janë realizuar vizita pune, pothuajse në të gjitha shkollat e komunës sonë.

-Donacionet dhënë shkollave:

Dt.09.09.2021, MASHTI, furnizon shkollat me material dezinfektues etj.

Dt.13.09.2021, Në DKA, FSK-Regjimenti i Dytë i Këmbëtorisë - Istog dorëzon donacion rreth 6000 maska shumëpërdorimshe për nxënësit e komunës së Deçanit.

Dt.27.09.2021, DKA, pranoj Donacion prej 10 mijë maskave mbrojtëse (njëpërdorimshe) për nxënësit e shkollave tona. Maskat i dhuroj përfaqësuesi nga Kompania për Sherbime Shëndetësore Shtepiake dhe Asistenca të Përgjithëshme - SPITEX KOSOVA z Besart Lokaj.

-SHFMU"Rexhep Kadrijaj" në Rastavicë. Mërgimtari nga Austria Sami Selmonaj, ndihmon shkollën me mjete anti covid, 300 maska, 200 palë dorëza, 6 litra dezinfektues, lecka për pastrim, si dhe 30 teste rapide për shkollën.

Kërkesat nga DKA:

Projekte nga fusha e Arsimit për bugjetin e vitit 2022-2024, dorëzuar në D. e Financave:

- 1.Renovim (mirëmbajtje) të shkollave.
- 2.Digjitalizimi i shkollave (vazhdon).
- 3.Furnizimi me pajisje laboratorike dhe kabinetike (Biologji, Fizikë, Kimi, Matematikë etj).
- 4.Kërkesë për trajtim të kërkesave nga punëtorët e arsimit-obligime dalë nga Kontrata kolektive.
- 5.Bursat për “Studentët e dalluar”, për vitin akademik 2020/2021.
- 6.Themelimi (ndërtimi ose adaptimi) i çerdheve të reja në Deçan.
- 7.Konkurs për Shkollën më të mirë në komunën e Deçanit - Çmimi “Njazi Ferizi”, për vitin shkollor 2021/2022.

-Projektet, paraqitur në Kërkesë për shkollat në komunën tonë, si projekte parashihen edhe me Planin Zhvillimor Komunal të Arsimit 2019-2022.

-DKA, Përgatitet lënda për Lejen e ndërtimit e Sallës së Edukatës fizike në SHMT “T. Kasumaj” në Deçan, më kërkesën e MASHT-it.

-Drejtori i DKA-së, dorëzon TIKa-s në Prishtinë një kërkesë për donacion shkollave në komunën tonë, bazuar në projektin “Digjitalizimi i shkollave”.

Dt.29.09. 2021, Në Asamblenë Komunale, me vota unanime kaloj edhe Draft Rregullorja për vlerësimin e shkollës më të mirë - çmimi "Njazi Ferizi".

-DKA, përkujdesje për procedurat rreth furnizimit me derivate - naftë (për ngrohje gjatë stinës së ftohtë) për 2 shkollat ML në Deçan.

Dt.23. 09. 2021 Raporti i DKA-s për MASHT, punonjës arsimor të vaksionuar 526 (me 1 dozë 118 dhe me 2 doza 408 punonjës).

Muaji TETOR:

Dt.01.10.2021. Pas aplikimit dhe shpalljeve të rezultateve nga GIZ, SHFMU "Rexhep Kadrijaj" në Rastavicë, është përfituese e projektit trevjeçar të GIZ-it gjerman "Fit for Jobs", i cili projekt ka për qëllim rritjen e intenzitetit të mbështetjes për shkollat specifike duke siguruar rritje të cilësisë në arsim dhe lehtësimin e procesit të tranzicionit të nxënësve duke i orientuar në karrierë.

Dt.06.10.2021. DKA organizon Takim pune me Komisionin (niveli komunal) për Vlerësim Pedagogjik të Fëmijëve me Nëvoja të Veçanta. Gjatë takimit u diskutua për rifillimin e punës së komisionit në vlerësimin e FNV, si proces shumë i domosdoshëm dhe lehtësim i punës së asistentëve të angazhuar në përkujdesjen e këtyre fëmijëve.

Dt.06.10.2021. Drejtori i DKA-së dhe zyrtari R. Bajramaj, mbajtën takim pune me zyrtarët nga OSBE, z. Ilen Madhavji - zyrtar për të drejtat e njeriut dhe Haxhi Thaçi - zyrtar pranë zyrës së OSBE në Pejë, temë diskutimi: Organizimi i procesit mësimor në shkollat e Deçanit.

Dt.13.10.2021. Takim pune, DKA me OJQ “Jeta” në Deçan. Bashkëpunimi, në vazhdim me projektin e ri “Fuqizimi i grave dhe të rinjëve për parandalimin e dhunës në baza gjinore” në përputhje me “Konventen e Stambollit”, përkrahur nga “Rrjeti i Grave të Kosovës”, aktivitete me shkollat e komunës së Deçanit.

Dt.18.10.2021. Vendimi i MASHTI-t për organizimin e mësimi online me 18 tetor 2021, në shkollat ku ishin qendra të votimit.

Dt.14.10.2021. Anëtarët e Komisioneve për Organizimin e Garave të Diturisë në nivel Komunal, janë nderuar me Mirënjohje nga DKA dhe Kryetari i komunës z. Bashkim Ramosaj.

Dt.18.10.2021. Nga DKA, në SIA- Pejë dorëzohet materiali (të dhënat) për mësimdhënësit në komunën e Deçanit.

Dt.25.10.2021, SHFMU "Rexhep Kadrijaj" në Rastavicë. Fillon procesi i dixhitalizimit të bibliotekës së shkollës. Realizimi i këtij programi bëhet ndihmën e Burbuqe Beqiraj Msc. e Shkencave Kompjuterike dhe Inxhinieri.

Dt.26.10.2021, Debat public-D. Rregullorja, vlerësimi për shkollën më të mirë-çmimi "N Ferizi".

Dt.26.10.2021, Stafi i Solidar Suisse në vizitë në Deçan, u organizua Dëgjimi publik me nxënësit, takim me drejtorin për arsim dhe zyrtarë tjerë komunal. Dëgjimi publik u realizua në kuadër të projektit Let's Debate Change, implementuar nga Teach for Kosova, nxënësit biseduan me drejtorin z.Vishaj për çështjet që lidhen me shkollat dhe të rinjtë.

Stafi i Solidar Suisse, në takim pune me drejtorin e DKA-së, u bisedua për bashkëpunimin e sukseshëm deri tani ndërmjet Solidar Suisse dhe Drejtorisë Komunale për Arsim dhe vazhdimin e këtij bashkëpunimi në të ardhmen me projekte për nxënësit në komunë e Deçanit.

SHFMU "Drita" në Gramaçel, me drejtor z.Mujë Avdiu, ka aplikuar dhe fituar projektin "Multikulturalizmin dhe Marrëdhëniet Ndëretnike në Arsim".

Dt.26.10.2021, DKA (drejtori) në Debat të hapur me nxënësit e dy shkollave të mesme në Deçan. Debati u organizua në kuadër të projektit Let's Debate Change i cili implementohet në dy shkollat e mesme nga Teach For Kosova me donator Solidar Suisse.

Dt.28.10.2021, Në Asamblenë Komunale, kaloj edhe Rregullorja për vlerësimin e shkollës më të mirë - çmimi "Njazi Ferizi".

Dt.28.11.2021, DKA me drejtorët e shkollave të Komunës së Deçanit, takim pune me Kryetarin Ramosaj. Zhvillimi i procesit mësimor në shkollat tona.

Dt.26.10.2021, **DKA-Zyrtari z.R. Bajramaj**, bashkë me psikologun dhe pedagogun (DKA), ishin pjesëmarrës në ëëbinarin me temën: "Ndërmjetësimi mes bashkëmoshatarëve si alternativë për adresimin e dhunës në shkolla", organizuar nga Koalicioni i OJQ-ve për Mbrojtjen e Fëmijëve - KOMF në bashkëpunim me Qendrën për Arsim të Kosovës -KEC.

Dt.29.10.2021, Trajnim i 26 mësimezhënësve, organizuar nga SBASHK-u në Deçan, përkrahur nga DKA (4 d. pune), tema e trajnimit: Ed. dhe Menaxhimi mjdisor në arsimin parauniversitar.

Dt.30.10.2021, në SHFMU "M. Çekaj" rivazhdojnë punimet finale në p. sportive.

-Nga bugjeti komunal për vitin 2021, investimet në infrastrukturen shkollore:

Kanë filluar dhe po vazhdojnë investimet në këto shkolla:

1. Gjimnazi "V. Frashëri", Lidhja (ura termike) në mes të objekti të shkollës dhe S. Sportit,
2. SHMT "T. Kasumaj", projekti i Qendres për Orientim në Karrierë,
3. SHFMU "D. e Baballoqit" Projekti i kanalizimit ujrat e zeza,
4. SHFMU "L. Selimi" paralelja në Llukë të Ultë, rrethoja e oborrit,
5. SHFMU "B. Curri" në Strelc të epërm, rrethoja e oborrit,
6. SHFMU "J. Gërvalla" paralelja në Dubovikë, rrethoja e oborrit,
7. SHFMU "D. e Kombit" në Strelc të ultë, rrethoja e oborrit,
8. SHFMU "L. e Prizrenit" rregullimi i 5 dhomave të mësimin në katin e parë Objekti i vjetër,
9. SHFMU "E. Mekuli", në Maznik,
10. SHFMU "Kuvendi i Verrave të Llukës", po ndërtohen objektet depo për dru,
11. SHFMU "S. Vokshi" në Prejlep, rregullimi i platosë para hyrjes në objektin e shkollës.

Pandemi COVID 19. 2 rastet me pandemi (nxënës).

Të gjitha shkollat zhvillojnë mësimin në Skenarin 1 (rikthim në objektet shkollore) sipas MASHTI-it, 2 shkollat e qytetit (SHFMU "L.P" dhe Gj. "V.F") kanë nga 3 paralele në mësim online (shkak numri i madh i nxënësve në klasa). Në shkolla po punohet me Protokol të MASHT-it dhe vendimit të TASK FORCËS së shkollës (përkrahur nga TFK).

Muaji NËNTOR:

Dt.02.11.2021, Staf i DKA-së, gjatë këtij muaji vizituan shumicën prej shkollave të komunës sonë. Nga afër u pa zhvillimi i procesit mësimor në këto institucione.

-DKA dhe MASHTI (ing.Isuf Gashi), vizitë shkollës në Glllogjan (punimeve në Shkollën e re), Kërkesa për Kopsht në objektin e vjetër të kësaj shkolle.

DKA, përgatitë (për MASHT) Projekt propozimin për ndërtimin e çerdhes së re në Deçan dhe kërkesat për adaptim të 2 objekteve shkollore për Kopshte (në Glllogjan dhe Dranoc).

Dt.03.11.2021, Drejtori i DKA-së, priti në takim pune përfaqësues nga KFOR Italian, Multinational CIMIC-Italia, Pejë. Tema e takimit: Dorëzimi i donacionit me laptop për shkollë.

Dt.25.11.2021,DKA (drejtori), me ftesë nga Fondacioni Kosovar për Zhvillim të Karrierës (KCDF), merr pjesë në Konferencën regjionale për Regjionin e Pejës, aktivitet në kuadër të Javës së mësimi gjatë gjithë jetës (JMGJJ) në Kosovë. Kjo javë është duke u organizuar nga DVV International dhe Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHTI).

Investimet në shkollë:

Nga bugjeti komunal (bugjeti i shkollave) për vitin 2021, vendosën perdet në klasa (dhomave të mësimi), këto shkollë: 1."Vëllezërit Frashëri"-Deçan, 2."Tafil Kasumaj"-Deçan, 3."Isa Boletini"-Isniq, 4."Bajram Curri"-Strelc i epërm, 5."Dëshmorët e Kombit"-Strelc i ulët, 6."Jusuf Gërvalla"-Prapaqan 7."Sylë Alaj"-Drenoc, 8."Lan Selimi"-Lumbardh, 9."Maxhun Çekaj"-Irniciq, 10."Sylejman Vokshi"-Prilep, 11."Esad Mekuli"-Maznik, 12."Dëshmorët e Baballoqit"-Baballoq, 13."Rexhep Kadrijaj"-Rostovicë.

-DKA, furnizon me maska dhe dezinfektues shkollat në komunë.

-Aktivitetet dhe Garat më nxënës:

Dt.05.11.2021, MASHTI ka organizuar fushatën për parandalimin e trafikimit me qenje njerëzore, në kuadër të kësaj fushate MASHTI organizon garë në nivel shtetëror përmes punimeve të nxënësve në edukatën figurative nga shkollat e Kosovës. Nga Komuna jonë me punimet e tyre garojnë 5 nxënës nga 4 shkollë (punimet janë dorëzuar në MASHT).

Dt.25.11.2021, DKA organizon Garat në recitime me nxënësit e SHFMU-ve, marrin pjesë rreth 40 recitues, juria nxjerrë më të mirët (respektim të masave ANTI COVID).

Dt.20.11.2021, Në shumicën e shkollave, me aktivitete simbolike shënohet 20 Nëntori- Dita Ndërkombëtare e të Drejtave të Fëmijëve (me respektim të masave ANTI COVID).

Dt.25 dhe 26.11.2021, Në shumicën e shkollave, me aktivitete simbolike shënohet 28 Nëntori- Dita e Flamurit (me respektim të masave ANTI COVID).

SHMT "Tafil Kasumaj", Teach for Kosova në kuadër të projektit të financuar nga Solidar Suiss "Let's debate change" dhe me mbështetjen e komunës së Deçanit. Grupe nxënësish të shkollës: "T. Kasumaj" dhe "V. Frashëri" morën pjesë në Debat, niveli Regjional fitues doli ekipi i nxënësve të shkollës "T. Kasumaj".

Projekti i fituar do të realizohet: Përmirësimin e bibliotekës komunale "D. e Lirisë" në Deçan. Në këtë projekt përfshiheshin: furnizimi i bibliotekës me libra më të kërkuara nga lexuesit dhe rregullimin e këndit për lexim. Projektin u emërua me emrin "Libri, pasuria e mendjes". Vlera e projektit është mbi 2000 €. Grupi fitues: nx. Rinesa Selmonaj dhe Edonisa Dautaj, klasa XI-2.

Trajnimet e mësimdhënësve:

Dt.17.11.2021, DKA në bashkëpunim. Me Këshillin Lokal për Orientim në Karrierë ka mbajtur takim me mësimdhënësit që ligjërojnë Orientimin në Karrierë në shkollat e mesme të ulëta dhe ato të mesme të larta në komunën e Deçanit.

Mësimdhënësve i'u prezantuan dhe diskutuan të gjeturat nga raportimi paraprak për zbatimin e Orientimit në Karrierë. Mësimdhënësit u njoftuan që trajnimi në Busulla.COM është i domosdoshëm për ta dhe kolegët tjerë. Në takim ishte edhe Drejtori i DKA-së.

Gjatë muajt Nëntor, Shoqata e Gruas "Jeta" në koordinim me DKA-në, e përkrahur me projekt nga RRGK-ja ka vazhduar me aktivitete (ligjerata me nxënës në disa prej shkollave) në kuadër të nismës "Fuqizimi i grave" dhe të rinjëve për parandalimin e dhunës me baza gjinore në përputhje me "Koventën e Stambollit" të përkrahur nga raundi i 15-të i fondit të grave të Kosovës.

Donacionet dhënë shkollave:

Dt.08.11.2021, KFORI Italian, Donacion - 102 laptop për shkolla. Kryetari i Komunës z. Bashkim Ramosaj, Drejtorja e Arsimit dhe drejtorët e shkollave të komunës së Deçanit, kanë pritur në takim Komandantin e Komandës Regjionale Perëndim (RCË) Kol.Andrea Bertazzo , nga KFORI u pranua një donacion prej 102 Laptop për nevojat e shkollave .

-SHFMU "H. e Dukagjinit", Glllogjan. K. i prindërve, furnizon nxënësit me uniforma të reja.

-SHFMU "M. Çekaj", z.Milazim Mushkolaj i dhuron pajisje për TIK,10 tastatura dhe 10 mausa.

-Panemia COVID 19. Dt.25.11.2021 Raporti i DKA-s për MASHT, punonjës arsimor të vaksionuar 522 (me 1 dozë 4 dhe me 2 doza 522 persona). 13 punonjës të pavaksionuar.

MUAJI DHJETOR:

SHMT "Tafil Kasumaj", Teach for Kosova në kuadër të projektit të financuar nga Solidar Suiss "Let's debate change" dhe me mbështetjen e komunës së Deçanit. Projekti i fituar po realizohet: Bibliotekës komunale "D. e Lirisë" në Deçan, u bë furnizimi i bibliotekës me tituj te ri dhe rregullimin e këndit për lexim.

Dt.02.12.2012, Stafi i QKMF në Deçan, fillon vaksinimin e nxënësve në 2 shkollat e mesme për të vazhduar tutje me shkollat tjera.

-DKA, me kryetarin e komunës ju shpërndan Mirënjohje nxënësve fitues në garat e recitatorëve në nivel komunal.

-**DKA**, për MASHTI-n përgatit Kërkesë për shkollat: Gjimnazi "V. Frashëri" dhe SHMP "T. Kasumaj" në Deçan,- Trajtimi i ujërave të zeza dhe shkarkimi i tyre në rrjetin e kanalizimit të qytetit . Dhe SHFMU "Lan Selimi" në Lumbardh- Hapja e Bunarit për ujë të pijës, dhe lidhja nga bunari deri në objektin e shkollës.

Stafi i DKA-së, gjatë këtij muaji vizituan shumicën prej shkollave të komunës sonë. Nga afër u pa zhvillimi i procesit mësimor në këto institucione.

Pandemia,për momentin nuk kemi raste me CVID 19. Të gjitha shkollat vazhdojnë mësimin në Skenarin 1 (rikthim në objektet shkolllore) sipas vendimit të MASHTI-it. Në shkolla po punohet me Protokol të MASHT-it dhe vendimit të TASK FORCËS së shkollës dhe TFK.

Aktivitetet e përditshme të zyrtarëve të DKA-së kanë vazhduar...

-Procedurat për konkurset - rekrutimi i stafit (punëtorëve) të ri arsimor, sipas kërkesave të shkollave, janë përkujdesur zyrtarët Xh. Bozhdaraj dhe B. Cacaj.

-Vazhdimisht kryhen obligimet administrative, pëlqime, vendime, kërkesa e shkresa tjera zyrtare nga zyrtari B. Prekalla.

-Realizimi dhe përcjellja e obligimeve financiare për shkolla nga zyrtarja Gj. Haklaj.

-Përkujdesja për zhvillimin e procesit mësimor nga zyrtarët R. Bajramaj dhe Z. Malaj.

-Ndryshimet e nevojshme në listat e pagave për punëtorët arsimor për muaj, janë përkujdesur zyrtarët Z. Malaj dhe B. Prekalla.

-Investimet në shkollat e komunës së Deçanit gjatë vitit 2021:

1. SHFMU "Esad Mekuli" në Maznik

- 5 loptopë (donacion KFORI Italian).
- Programi i Efijencës, objekti i shkollës (presim të filloj, investon MZHE).
- Depo e druve për nxemje (investon Komuna).
- Perdet në klasa (dhoma mësimi), bugjeti i shkollës dhe i Komunës.

2. Gjimnazi "V. Frashëri" në Deçan

- Kabineti i Fizikës (investim nga familja Lataj dhe nga Komuna).
- 5 loptopë (donacion KFORI Italian),
- Perdet në klasa (dhoma mësimi), bugjeti i shkollës dhe i Komunës.
- Korridori - lidhja e objektit të shkollës me sallën sportive (investon Komuna).

3. SHFMU "L. e Prizrenit" në Deçan

- 5 loptopë (donacion KFORI Italian).
- Ulëse oborri, shporta mbeturinash dhe fidane dekorative (donator Hixhena në Deçan).
- Renovohet dyshemeja e 5 dhomave (klasave) të mësimi në objektin e vjetër.

4. SHFMU "Dëshmorët e Vokshit" në Pobergjë

- 8 projektorë (donacion nga Shoqata humanitare "Mentori&Agimi" Zvicer).
- 5 loptopë (donacion KFORI Italian).

5. SHFMU "Isa Boletini" në Isniq

- Kabineti i Informatikës, 10 kompjuterë-PC (donacion nga diaspora Bajram Stojkaj).
- 5 loptopë (donacion KFORI Italian).
- Perdet në klasa (dhoma mësimi), bugjeti i shkollës dhe i Komunës.

6. SHFMU "Ardhmëria" në Beleg

- Kabineti i Informatikës, 10 kompjuterë-PC (donacion nga diaspora).
- 5 loptopë (donacion KFORI Italian).
- Asfaltohet rruga e shkollës - nxënësve (investim nga Komuna).
- Rregullimi i parkingut për automjete (investim nga Komuna).
- Puntoria e p. teknik (investon shkolla dhe komuna).
- Rrethoja e oborrit të shkollës (në procedurë nga MASHT).
- Ulëse oborri, shporta mbeturinash dhe fidane dekorative (donator Hixhena në Deçan).
- Adaptimi dhe renovimi i 4 kabineteve (investon shkolla dhe komuna).

7. SHFMU "Dëshmorët e Baballoqit" në Baballoq

- 5 loptopë (donacion KFORI Italian),
- Perdet në klasa (dhoma mësimi), bugjeti i shkollës dhe i Komunës.
- Vija e ujrave të zeza afër objektit të shkollës (investon Komuna).

8. SHFMU "J. Gërvalla" në Prapaqan

- 5 loptopë (donacion KFORI Italian).
- Perdet në klasa (dhoma mësimi), bugjeti i shkollës dhe i Komunës.
- Rrethoja e oborrit në Dubovikë (investon Komuna).
- Ulëse oborri, shporta mbeturinash dhe fidane dekorative (donator Hixhena në Deçan).
- Punimi i dyerve (investim i komunitetit).
- Rregullimi i rrethojës së shkollës 518 m, gërryerje, prerje dhe lysterje (investim i komunitetit).
- Rregullimi i dyerve fundore (lindje) (investim nga Mujë Berisha).
- Blerja e mjeteve të punës-karroca, gypa, kablla, lopata, dara etj (shkolla dhe komuna).

9. SHMP “T. Kasumaj” në Deçan

- Ndërtimi Sallës së edukatës fizike (investon MASHT).
- Ndërtimi i Qendrës për Orientim në Karrierë (investon Komuna).
- 5 loptopë (donacion KFORI Italian).

10. SHFMU “F. Konica” në Ratish

- Ndërtimi i shkollës së re (investon MASHT).
- 2 loptopë dhe 1 projektor (donacion nga Komuna).
- 5 loptopë (donacion nga KFORI Italian).

11. SHFMU “Heronjtë e Dukagjinit” në Gllogjan

- Ndërtimi i shkollës së re (investon MASHT).
- 5 loptopë (donacion nga KFORI Italian).
- Projekti i huamarrjes - Banka Botërore (kompjuterë, Projektorë etj).

12. SHFMU “Lan Selimi” në Lumbardh

- Ndërtimi i shkollës së re (investon MASHT).
- Rregullimi i rrethojës së oborrit të shkollës në Llukë të Ulët (investon Komuna).
- 5 loptopë (donacion nga KFORI Italian).

13. SHFMU “B. Curri” në Strelc të Epërm

- 5 loptopë (donacion nga KFORI Italian).
- Rregullimi i rrethojës së oborrit të shkollës (investon Komuna).
- Shkumbin Malaj, i dhuron shkollës 4 kamera komplet.
- Ahmet Dobrunaj “ARTIDA”, 2 komplete ngjyra për nevojat e shkollës.
- Ilmi Mujaj Zvicer, ndihmë në infrastrukturën shkollore pajisje dhe mirëmbajtje për shkollën si dhe 24 komplete sportive për nxënës.
- Zija Avdimetaj, 2 topa për nxënësit e shkollës.
- Arben Idrizaj nga Peja me punë në Austri, 13 komplete sportive për nxënësit e shkollës.
- Bekë Mulaj-Zvicer, dhuroi 32 kompjuterë të përdorur për nevojat e nxënësve të shkollës.

14. SHFMU “Drita” në Gramaçel

- Ndërtimi i shkollës së re (investon MASHT).
- 5 loptopë (donacion nga KFORI Italian).
- Ulëse oborri, shporta mbeturinash (donator Hixhena në Deçan).

15. SHFMU “K. V. LLukës” në Llukë të Epërme

- 5 loptopë (donacion nga KFORI Italian).
- Ndërtimi i depos së druve për nxemje (investon Komuna).
- Ulëse oborri, shporta mbeturinash dhe fidane dekorative (donator Hixhena në Deçan).
- Vendosja e perdeve në dy objektet (donacion nga familja Tahirukaj).
- Furnizimi i Bibliotekës së shkollës (donacion nga bashkëfshatarët e Llukës).

16. SHFMU “S. Alaj” në Drenoc

- 5 loptopë (donacion nga KFORI Italian).
- Kabineti i Informatikës, 10 kompjuterë (PC) (donacion nga diaspora Bajram Stojkaj).
- Ulëse oborri, shporta mbeturinash dhe fidane dekorative (donator Hixhena në Deçan).

17. SHFMU “R. Kadrijaj” në Rostovicë

- 5 loptopë (donacion nga KFORI Italian).
- Projekti i huamarrjes - Banka Botërore (kompjuterë, Projektorë etj).
- Ulëse oborri, shporta mbeturinash dhe fidane dekorative (donator Hixhena në Deçan).
- Perdet në klasa (dhoma mësimi), bugjeti i shkollës dhe i Komunës.

18. SHFMU “D. e Kombit” në Strelle të Ultë

- 5 loptopë (donacion nga KFORI Italian).
- Rrethoja e oborrit dhe fushës sportive (investon komuna).

19. SHFMU “S. Vokshi” në Prejlep

- 5 loptopë (donacion nga KFORI Italian).
- Oborri-platoja para shkollës (investon Komuna).
- Ulëse oborri, shporta mbeturinash dhe fidane dekorative (donator Hixhena në Deçan).

Projektet e rëndësishme që janë realizuar (po realizohen) nga MASHT për vitin 2021:

- 4 shkolla të reja janë ndërtuar (po ndërtohen).
- 7 shkolla janë pajisur me inventar të ri shkollor.
- 3 shkolla janë pajisur me SET makina pastrimi.

MASHTI i ka në procedurë këto projekte nga viti i kaluar:

- SHFMU “D. e Baballoqit”, renovim i brendshëm i shkollës.
- SHFMU “Drita” në Gramaqel, fushat sportive.
- SHFMU “M. Çekaj” në Irzniq, renovim i brendshëm i shkollës.
- SHFMU “Ardhmëria” në Beleg, rrethoja e oborrit.
- SHFMU “J. Gërvalla” në Prapaqan, salla e aktiviteteve, parkingu dhe sistemi i kamerave.
- MASHT, kërkon kërkesë nga DKA-ja. Në bazë të bashkëpunimit të donatorëve në mes MASHTI-it dhe Rotary Club Prishtina International, për bashkëfinancim për furnizimin me ujë të pijes në shkolla në të gjithë territorin e Republikës së Kosovës, për krijimin e kushteve me të mira dhe me të shëndetshme në objektet arsimore. DKA në Deçan përgatitë kërkesat (sipas nevojave). Në këtë projekt si shkolla mund të përfitojmë: Hapjen e puseve me elemente përcjellëse deri tek kroi për furnizim me ujë të pijshëm dhe Trajtimi i ujerave fekale deri tek shkarkimi etj. Behet fjalë për shkollat që kanë vështirësi me furnizim me ujë të pijes në shkollat fillore dhe të mesme.

Shkollat, furnizohen nga Komuna dhe donatorët tjerë me:

- 2 TV SMART, 125 loptopë, 52 kompjuterë, 8 projektorë 5 fotokopje-printer.
- Mjete mësimore dhe kabinete për: TIK, Biologji, Fizikë, Kimi dhe Matematikë.

-Hartimi i Planeve dhe Rregulloreve në nivel komunal (DKA):

- Hartimi i Rregullores Për “Institucionet Edukative – Arsimore të Komunës së Deçanit”
- Rregullorja “Shkolla me Përformancë me të mirë” Çmimi “Njazi Ferizi” (në Asamble).
- Themelimi i Qendrës për Zhvillim në Karrierë (shfrytëzimi për trajnime të mësimdhënësve).
- Themelimi i Qendrës për Orientim në Karrierë në SHMT “T. Kasumaj”.
- Trajnimi i vazhdueshëm i mësimdhënësve nga MASHT dhe DKA (me iniciativë të DKA-së me ekspertë Deçanas), OJQ-të e ndryshme etj.
- Projekti “Digjitalizimi i shkollave 2019-2022” (po vazhdon).
- Projekti “Garat me nxënës në Nivel Komunal” (2020 dhe 2021).
- Projekti “Debate me nxënës” SHML, Partneritet, TEACH FOR KOSOVA & Solidar Suiss.
- Projekti “Orientimi i nxënësve në karrierë”, Partneritet me BUSULLA.com (Trajnimi i mësimdhënësve dhe përdorimi i platformës online).
- Projekti: Garat e diturisë (mësimore), kulturore dhe sportive në nivel komunal për vitin shkollor 2020/ 2021 (i reduktuar për shkaqet COVID 19), me nxënësit e shkollave tona në nivelin shkollë dhe nivelin komunal janë realizuar, sipas kalendarit përgatitur nga DKA.

-Projekti: Garat e diturisë (mësimore), kulturore dhe sportive në nivel komunal për vitin shkollor 2021/ 2022, me nxënësit e shkollave tona në nivelin shkollë dhe komunal kanë filluar dhe po vazhdojnë për vitin shkollor 2021/2022, sipas kalendarit përgatitur nga DKA.

-Garat me nxënësit e shkollave tona:

-Olimpiada e Matematikës, niveli komunal dhe republikan (2021),

-Garat e Fizikës niveli komunal dhe republikan (2021),

-Garat në nivel komunal në lëndën e: Matematikës, fizikës, Gj. Shqipe, Gj. Angleze (2021),

-Garat sportive niveli komunal, regjional dhe republikan (2021),

-Garat e recitatorëve, niveli komunal (2021).

-Shkollat me suksese në garat e nivelit Republikan:

-Nxënësit e SHMT “T. Kasumaj”,

-Nxënësit e Gjimnazit “V. Frashëri”,

-SHFMU “B. Curri” në Strelc të Epërm në gara sportive shkollore (2021),

-SHMT “Tafil Kasumaj”, Teach for Kosova në kuadër të projektit të financuar nga Solidar Suiss “Let’s debate change” dhe me mbështetjen e komunës së Deçanit. Grupi i nxënësve të shkollës, fituan vendin e parë në nivel regjioni.

-Investimet nga Komuna në infrastrukturën shkollore, viti - 2021, lista sipas shkollave:

1.Gjimnazi “V. Frashëri”, Lidhja (ura termike) në mes të objektit të shkollës dhe s. së sportit.

2.SHMT “T. Kasumaj”, projekti i Qendrës për Orientim në Karrierë.

3.SHFMU “D. e Baballoqit” Projekti i kanalizimit - ujrat e zeza.

4.SHFMU “L. Selimi” paralelja në Llukë te Ultë, Rrethoja e Oborrit.

5. SHFMU “B. Curri” në Strelc të epërm, Rrethoja e Oborrit.

6. SHFMU “J. Gërvalla” paralelja në Dubovikë, Rrethoja e Oborrit.

7. SHFMU “D. e Kombit” në Strelc të ultë, Rrethoja e Oborrit dhe e fushën sportive.

8.SHFMU “E. Mekuli” në Maznikë, Depo (shupa) e druve për nxemje.

9.SHFMU “K. V. e Llukës” në Llukë te epërme, Depo (shupa) e druve për nxemje.

10.SHFMU “L. e Prizrenit” në Deçan, Renovohet dyshemeja e 5 klasave në objektin e vjetër.

11.SHFMU “S. Vokshi” në Prejlep, Zgjerohet oborri-platoja para shkollës (investon Komuna).